

Pensionistët ushtarak vizituan Myftiu i Bashkësisë Islame të Gostivarit, ku i përshëndeti zëvendësi i myftiut kryesor, Milazim Zendeli dhe i njoftoi me misionin që e realizon kjo bashkësi fetare

Shoqata e Pensionistëve të Luftës së RM Ekskursioni dhe vizita e SHP Gostivar

Më 16 shtator 2017, me iniciativë të Shoqatës së Pensionistëve të Luftës, u organizua takim me udhëheqjen e SHP Gostivar dhe është realizuar vizitë të qytetit dhe rrethinës me dyzet pensionistë të luftës. Pas mirëseardhjes së ngrohtë, kryetari i SHP Gostivar, Nijazi Xhelili, përshëndeti mysafirët dhe në emër të Këshillit ekzekutiv dhe anëtarësisë shprehu falënderim për iniciimin e këtij takimi, të cilin e vlerësoi si shumë të rëndësishme për afrimin e pensionistëve të etniteteve të ndryshme dhe zgjerimin e miqësisë.

Gjatë takimit ai foli edhe për aktivitetet dhe sukseset që i ka arritur shoqata në shumë sfera si në nivel rajonal ashtu edhe republikan.

Nijaziu tha se ky shembull duhet të ndiqet edhe nga shoqatat tjera të pensionistëve, ndërsa që të përforcohet bashkëpunimi dhe shoqërimi, propozoi initiative për vëllazërimin e dy shoqatave. Fjalën përshëndetëse e përfundoi me shpërndarjen e materialit promovues dhe fletushkave për infrastrukturë në Komunën e Gos-



tivarit si dhe bukuritë natyrore të rrethinës.

Në emër të udhëheqjes dhe anëtarësisë SHPL, falënderim për praninë dhe fjalët e mira të nikoqirëve shprehu sekretari i SHPL, Eftim Mishovski. Falënderim të posaçëm shprehu edhe anëtari i KE të SHPL, Mendo Dimovski, i cili theksoi aspektet pozitive të këtij takimi edhe e përshëndeti iniciativën për vëllazërimin e shoqatave.

Pastaj, pensionistët

ushtarak vizituan Myftiu i Bashkësisë Islame të Gostivarit, ku i përshëndeti zëvendësi i myftiut kryesor, Milazim Zendeli dhe i njoftoi me misionin që e realizon kjo bashkësi fetare. Mysafirët e vizituan kompleksin e BFI, ndërsa hoxha Jakup Jakupi i njoftoi me rëndësinë dhe funksionimin e Medresesë, Xhamisë dhe Saat Kullës.

Të udhëhequr nga nikoqirët, pensionistët ushtarak e vizituan edhe Kishën Shën

Bogorodica dhe Xhaminë. Takimi përfundoi në fshatin Vrutok tek burimi i Vardarit ku u shkëmbyen përvoja nga aktiviteti i shoqatës dhe në atmosferë relaksuese në restorantin Burimi 3 të gjithë u shoqëruan dhe u kënaqën në ambientin e bukur natyror.

Kjo ngjarje u ndjek nga mediet lokale, ndërsa deklarata për media dhanë Nijazi Xhelili dhe sekretari i ZVP Eftim Mishovski. (Vadije Zendeli)

SHP Strugë



Në rekreacion klimatik në Banjat e Dibrës

Nga numri i madh i pensionistëve të interesuar strugan për rekreacion klimatik në banja, këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar vetëm 50 anëtarë të shoqatës, të cilët kanë qëndruar kryesisht në Banjat e Dibrës – Kosovrasti dhe Capa – Banishte. Impresionet për shërbimet kualitative dhe cilësitë shëruese të banjave na i dhanë pensionistët Dafina, Radmilla, Borka, Zorica, si dhe pensionistët nga grupi i meshkujve: Anxhellko Budinoski, Viktor Dishlioski, Stojani, Nuredini, Lupço, Klimeja dhe të tjerë, të cilët me kënaqësi kanë treguar për qëndrimin e tyre dhe përmirësimin e shëndetit. Të dyja grupet, të cilat në tetor të këtij viti qëndruan në banjat, koha e bukur ju mbajti që në mënyrë të pavarur të organizojnë vizitë të dy manastireve të kësaj ane, Shën Jovan Bigorski dhe Shën Georgi Pobedonossec në fshatin Rajçica.

Në manastirin Bigorski kanë vizituar ikonostasin dhe ikonën e Shën Xhon Pagëzorit, për të cilën besohet se ka fuqi çudibërëse, ndërsa gjithashtu ishin të impresionuar nga manastiri i njohur i grave, shenjtërinë shpirtërore në Rajçicë, ku motrat me kënaqësi kanë shëtitur pensionistët kureshtar nëpër konakë.

Disa prej tyre për herë të parë kanë parë punëtorinë e Zografskit dhe u njoftuan me mjeshtrinë e prodhimeve të rrobaqepësisë, ndërsa i pashmangshëm ishte edhe llokumi i përgatitur në këtë manastir. Gjatë qëndrimit në banja pensionistët këndshëm janë befarsuar dhe jashtëzakonisht të lumtur nga vizita e anëtarëve të KE të Shoqatës të udhëhequr nga kryetari Millorad Trposki, nënkryetari Zija Asllani dhe sekretari Idriz Mustafai, ku u njoftuan me kushtet dhe kualitetin e shërbimeve. (Stojan Kukuneshoski)

SHP Kumanovë

Takimi multietnik në Likovë

SHP Kumanovë, në bashkëpunim me Degën e pensionistëve të Likovës, më 12 tetor kanë realizuar ekskursion njëditor deri tek Liqeni i Likovës dhe dy akumulimet, Glanja dhe Likovë. Takimi tradicional multietnik këtë vit ka përjetuar edicionin e katërt, ndërsa pensionistët kanë pasur një mundësi të jashtëzakonshme për të parë liqenin, të shëtisin përreth digës gjithë atë ta vërejnë përmes fotografive.

Mirëseardhje të ngrohtë mysafirëve në emër të nikoqirit u dëshiroi Hulusi Saliu, ndërsa për aktivitetet më të reja të shoqatës së pensionistëve nga Kumanova, informoi Spirko Nikolovski. Përshëndetjet e tyre i përcollën edhe përfaqësuesit e SHP Kri-



va Pallanka, të cilët janë vizitorët e rregullt të takimit.

Pamja e vetë liqenit ishte e mrekullueshme, e shkëlqyer nga rrezet e diellit, pamje jashtëzakonisht e bukur. Ditë e ngrohtë tetori, me diell, çdo gjë u shkonte për shtati vizitorëve të digës Gillanja. I

pashmangshëm ishte edhe fotografimi për kujtim nga shëtitja dyorëshe. Shoqërimi më tutje vazhdoi në restorantin "Kodra", i vendosur në vet liqenin, ku Shoqata e të sëmurëve nga diabeti organizoi aksion për matjen e sheqerit në gjak. Në mënyrë më të de-

tajuar për sëmundjen e sheqerit ka folur doktori specialist Ismail Bajrami, i cili në këtë rast ka potencuar shkaqet për paraqitjen e sëmundjes, por edhe mënyrat e shërimit dhe parandalimit të së njëjtës. Pensionistët me kujdes të madh kanë përcjellë ligjëratën edukative, ndërsa pastaj parashtronin pyetje, ndërsa një pjesë e tyre kanë ndarë përvojat dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me sëmundjen e sheqerit.

Pas shoqërimit disa orësh, pensionistët e Kumanovës u larguan nga Likova, të kënaqur nga ajo që kanë kaluar një ditë të këndshme, me dëshirë që vitin e ardhshëm sërish të vizitojnë liqenin dhe të shijojnë bukuritë natyrore. (Jasmina Todorovska)

SHIP SHPI Tetovë

Ndihma humanitare për 60 anëtarë

Në Shoqatën e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensionit invalidor realizohen dy aktivitete më masovike, për të cilat janë të interesuara anëtarët: ndihma humanitare në të holla të kategorisë së pensionistëve me të ardhura më të ulëta dhe furnizim me dru për ngrohje për të gjithë të interesuarit. Këtë vit ndahen mjete të njëhershme humanitare financiare për 60

anëtarë, ndërsa shuma është nga 2000 denarë. Shfrytëzuesit janë kryesisht me propozim të organizatave të vendit, me të cilat mbulohet i gjithë rajoni i veprimit të Shoqatës dhe të 25 delegatëve të Kuvendit. Për ndarjen e ndihmës humanitare respektohen dispozitat nga rregullorja e posaçme.

Kryetari i Shoqatës, Gido Bojçevski, ka informuar se sivjet janë paraqi-

tur 350 anëtarë të cilëve u ndahen rreth 3000 metra kub dru për ngrohje. Sipas Bojçevskit, dy arsye kanë kushtëzuar interesimin e këtyllë të madh: pagesa me këste dhe çmimi më i ulët se ai që ofrohet në treg. Drutë për ngrohje falas transportohen edhe tek secili shfrytëzues, pasi të paguhet kësti i fundit. Ky është viti i nëntë që kur Shoqata realizon këtë aktivitet.

Në Shoqatë thonë se në tërësi realizohen de-tyrat programore, falë angazhimit jo vetëm të delegatëve të Kuvendit, por edhe të të gjithë 27 degëve të vendit në të cilat janë përfshirë 2800 anëtarë. Me kryetarët e degëve të vendit mbahen këshillime të kohëpaskohshme, përmes të cilave planifikohen aktivitetet masovike dhe individuale. Shoqata ka lid-



hur marrëveshje me të gjitha banjat shëruese, ndërsa për anëtarët është siguruar lirim prej 10 për qind nga çmimi i pensionit. Për ndryshe, Shoqata e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve

të pensionit invalidor Tetovë vepron në rajonin e Pollogut të poshtëm në të cilin gjenden komuna e Tetovës, Tearcës, Jegunovcës, Zhelinës, Brvenicës dhe Bogovinës. (G. Eftoski)